



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Raporti vjetor 2023, për procesin e konsultimit publik, realizuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

1.Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) për vitin 2023 ka miratuar 1 akt që plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e procesit të konsultimit publik:

1. Projektligj “Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar”;

Në procesin e konsultimit publik për këtë projektakt u përdorën metodat si vijojnë:

- Konsultimi publik nëpërmjet RENJKP;
- Konsultim në kuadër të urdhrit të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr.194, datë 3.6.2022, për ngritjen e Grupit Ndërmnistror të Punës, për hartimin e projektligjeve.

Konsultimi publik i projektligjit ka patur një kohëzgjatje 20 ditë pune nga momenti i shpalljes në RENJKP. Projektakti është shpallur në regjistër për konsultim në datën 22.6.2022 dhe afati i fundit ishte data 19.7.2022. Konsultimi publik ishte i hapur për çdo individ apo organizatë të interesuar për të dhënë mendim apo sugjerime mbi projektligjin.

Nuk ka patur komente për konsultimin e këtij projektakti në RENJKP.

Ndërkohë janë zhvilluar disa takime konsultuese me anëtarët e Grupit Ndërmnistror të Punës të ngritur për hartimin e këtij projektligji me urdhër të ministrit. Takimet në strukturat e brendshme janë mbajtur që me miratimin e VKM nr.81, datë 9.2.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore për MEPJ”, që kaloi çështjet e diasporës në përgjegjësinë e MEPJ.

Nga miratimi i urdhrit nr.194, datë 3.6.2022, janë mbajtur dy takime në datat 6 dhe 9 qershor 2022, si dhe korrespondencë shkresore ndërinstitucionale për projektligjin “Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017, “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar”, nr.10458, datë 25.7.2022.

Korrespondencë elektronike nëpërmjet sistemeve e-akteve në qershor, tetor dhe nëntor 2022.

Projektligji është konsultuar paraprakisht edhe me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, si dhe me Departamentin e Administratës Publike.

2.Analiza e konsultimeve të kryera

2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. *Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?*

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka miratuar gjithsej 47 akte në Këshill të Ministrave nga të cilat 9 në bashkëpunim me ministri të tjera.

2.1.2. *Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

Është konsultuar një projektakt, që plotësonin kriteret për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, në përputhje me ligjin nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

2.1.3. *Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

Projektligji është konsultuar me raport VNR-je.

2.1.4. *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Kriteret e përjashtimit janë përdorur për 6 projektakte të parashikuara në PPAP 2023, në përputhje me nenin 4(b) të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare, konkretisht:

- Projektvendim "Për miratimin në parim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës për punësimin e anëtarëve të familjes së punonjësve në misionet diplomatike dhe postet konsullore";
 - Projektvendim "Për disa shtesa në Vendimin nr.1128, datë 30.12.2020 e Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara";
 - Projektvendim "Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim në fushën e diasporës";
 - Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.72/201p "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"" - Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare në kuadër të BE-së, Këshillit të Evropës, Komitetit MONEYVAL;
 - Projektvendim "Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sllovakisë, për punësimin e familjarëve të diplomatëve të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore";
 - Projektvendim "Për hapjen/mbylljen e misioneve diplomatike/posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë".
- Përjashtimet janë parashikuar për 1 projektakt të parashikuar në PKIE, ndërsa nuk ka akte të lidhura me strategjitë e sektorit.

2.1.5. *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Një projektligj.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Konsultimi publik i projektligjit “Për shfuqizimin e ligjit nr.115/2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i ndryshuar”, është zhvilluar përgjatë vitit 2022 kur është iniciuar akti.

Për vitin 2023 nuk janë zhvilluar konsultime publike pasi nuk janë hartuar akte që janë objekt i ligjit të konsultimit publik.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat më të përdorura janë konsultimi nëpërmjet RENJKP dhe konsultimi në kuadër të Urdhrave për ngritjen e GNP.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e konsultimit ndërinstitucional.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Janë organizuar konsultime paraprake brenda institucionit dhe ndërinstitucionale.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Procesi i konsultimit ka qenë i hapur për 20 ditë pune.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ishte 20 ditë pune.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit në vitin 2022 ka qenë 20 ditë pune.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Nuk ka patur palë interesi të jashtëm në grupet e punës brenda MEPJ-së.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Referojuni pikës 2.4.1.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Palët e interesuara që morën pjesë në të gjithë fazat e konsultimit publik ishin pjesëmarrës të institucioneve shtetërore. Pati 3 komente.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Pjesëmarrësit në procesin e konsultimit publik të projektligjit kanë qenë përfaqësues të tre institucioneve.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Këtë vit nuk ka patur akte që t'i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Gjatë procesit të konsultimit publik ka patur 3 komente.

2.5.2 *Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Të gjithë komentet janë pranuar plotësisht.

2.5.3 *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Komentet e mbledhura dhe të pranuar plotësisht reflektojnë ecurinë e procesit për vitin 2022, kohë në të cilën është zhvilluar procesi i konsultimit të projektligjit në subjekt. Për vitin 2023 nuk është zhvilluar proces konsultimi publik pasi nuk janë hartuar dhe miratuar akte të tjera objekt konsultimi publik.

2.5.4 *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Raportet VNR për projektligjin e konsultuar janë rishikuar.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Për procesin e konsultimit publik janë publikuar raportet e Vlerësimit të Ndikimit, raportet individuale dhe ai vjetor në RENJKP dhe portalin e MEPJ të ndërlidhur me RENJKP.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Nuk ka patur raporte të pa publikuara.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2023 sikurse është cituar më lart nuk ka akte të konsultuara.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Nisur nga natyra e fushës së përgjegjësisë institucionale të MEPJ, pjesa dërrmuese e projektakteve të propozuara nga MEPJ janë të natyrës diplomatike dhe për rrjedhojë nuk plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik, në kuptim të nenit 4(b) të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", që lidhet me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare dy dhe shumëpalëshe. Ndaj, këtë vit nuk ka patur sfida në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri.